

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË  
ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“THE ELIXIR CLINIC” SHPK**

**KREU I  
THEMELIMI, ZOTËRIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, SELIA**

**Neni 1  
Ortakët themelues**

Sot më datë 16.01.2024, ortakët themelues të shoqërisë:

- a) **Malvina Gjikhuri**, atësia Krenar, amësia Valentina, shtetas Shqiptar, lindur në Vlorë dhe banues në Vlorë, me adresë Rajoni 1, Lgj. 15 Tetori, Nd. 176, Vlorë, Vlorë 9401, lindur më 26.02.1988, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me ID nr. 035143053 dhe nr. Personal I85226112H;
- b) **Orkida Bleta**, atësia Krenar, amësia Valentina, shtetase Shqiptare, lindur në Vlorë dhe banuese në Vlorë, me adresë Osman Haxhiu; Vlorë; 0000; Vlorë, lindur më 09/01/1985, gjendja civile “beqare”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035193405 dhe nr. personal I55109074O.

Hartojnë këtë Akt Themelimi dhe Statut të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**THE ELIXIR CLINIC**” sh.p.k, mbështetur në ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe ligjin 9723 datë 3.05.2007 “Për qendrën kombëtare të regjistrimit”, i ndryshuar, si më poshtë vijon.

**Neni 2  
Forma ligjore dhe emërtimi i shoqërisë**

- 1) Emërtimi i shoqërisë është “**THE ELIXIR CLINIC**” sh.p.k.
- 2) Shoqëria është person juridik i së drejtës shqiptare, organizuar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar (më poshtë referuar “**Shoqëria**”).
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik që nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Shoqërive Tregtare, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**Neni 3:  
Objekti**

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:
  - a. Qëndër estetike;
  - b. Import të produkteve estetike, kozmetike etj;
  - c. Trajtimet e fytyrës.



**Neni 4**  
**Kohëzgjatja**

- 1) Shoqëria tregtare **“THE ELIXIR CLINIC” sh.p.k**, do të përmbushë objektin e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.

**Neni 5:**  
**Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në adresën: Rruga “Sami Frashëri”, kati I-rë, Nr. Pasurie 2/704+1-N, Nr. Pasurie 2/134+19-333, Nr. Pasurie 2/134+19-333/1, Z.K 8270, Tiranë.
- 2) Asambleja e shoqërisë mund të vendosë të transferojë Selinë e Shoqërisë në një vend tjetër apo mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe/ose zyra përfaqësimi të Shoqërisë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri shqiptare dhe/ose të huaja që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

**Neni 6:**  
**Dokumentet e shoqërisë**

- 1) Të gjitha shkresat, formularët e urdhrave apo çdo dokument tjetër korrespondence, nxjerrë nga shoqëria, degët apo zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë të dhënat e mëposhtme:
  - a. numrin unik të identifikimit;
  - b. formën ligjore të shoqërisë;
  - c. vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;
  - d. të dhëna nëse shoqëria është në likuidim.
- 2) Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty

**KREU II**  
**KAPITALI**

**Neni 7**  
**Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) Lekë, i papaguar. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre.
- 2) Kapitali i Shoqërisë është i ndarë në 2 (dy) kuota. Çdo kuote i takon e drejta e nje vote.
- 3) Kuotat do të zotërohen nga ortakët sipas ndarjes së mëposhtme:
  - a. Ortaku themelues Malvina Gjicknuri, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50,000 (pesëdhjetë mijë) Lekë, që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
  - b. Ortaku themelues Orkida Bleta, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50,000 (pesëdhjetë mijë) Lekë, që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.



- 4) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

### **Neni 8**

#### **Kalimi i kuotave dhe e drejta e parablerjes**

- 1) Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a. kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b. shitblerjes;
  - c. trashëgimisë;
  - d. dhurimit;
  - e. çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 2) Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
- 3) Pjesët e kapitalit mund tu transferohen të tretëve pjesërisht apo plotësisht vetëm me Vendim Të Asamblesë së Ortakëve
- 4) Ortaku që do të shesë kuotat e tij teresisht, apo pjesërisht duhet me parë të njoftojë me shkrim ortakun tjetër të shoqërisë. Ortaku tjetër ka të drejtën e blerjes së parë. Kete të drejta ortaku duhet ta ushtrojë Brenda 30 (tridhjetë) Diteve nga dita e njoftimit.
- 5) Në rastin e mos ushtrimit të së drejtës së blerjes së parë, ortaku që do të shesë kuotat duhet të njoftojë emërin e blerësit dhe kushtet, të cilat nuk duhet të jenë më të favorshme se sa ato të afuara ortaku tjetër të shoqërisë.
- 6) Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit.

### **Neni 9**

#### **Zmadhimi/zvogëlimi i kapitalit**

- 1) Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë mund të bëhet me Vendimi të Asamblese së Ortakëve si dhe në përputhje me kërkesat ligjore.

## **KREU III**

### **STRUKTURA DREJTUESE**

### **Neni 10**

#### **Organet e shoqërisë**

- 1) Shoqëria vepron nën regjimin e pronës private dhe merr përsipër vetë të drejtat dhe detyrimet Kontraktore.
- 2) Organet e shoqërisë janë:
  - a. Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë
  - b. Administratori



## Neni 11 Asambleja e Ortakëve

- 1) Asambleja e Ortakëve përbëhet nga ortakët e shoqërisë. Ajo drejtohet nga Administratori i shoqërisë ose nga çdo person tjetër i zgjedhur nga Ortakët.
- 2) Asambleja e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b. ndryshimet e statutit;
  - c. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - d. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
  - f. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - h. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - i. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - k. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - l. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - m. miraton lidhjen e kontratave për dhënie dhe marrje të drejtash apo ekskluzivitet për tregtimin e mallrave të shoqërisë;
  - n. miraton lidhjen e kontratave për blerje, shitje, tjetërsim të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme të shoqërisë
  - o. merr vendime të tjera në dobi të veprimtarisë tregtare të shoqërisë.
- 3) Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 4) Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite

## Neni 12 Thirrja e Asamblesë së Ortakëve

- 1) Asambleja e Ortakëve thirret sa herë është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
- 2) Asambleja e përgjithshme thirret nga Administratori ose ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë.



- 3) Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë

### Neni 13

#### Pjesëmarrja në vendime

- 1) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- 2) Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të kualifikuar, Asambleja e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të shoqërisë.
- 3) Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Në rastet e tjera Asambleja e Ortakëve vendos me më shumë se 50% të votave të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje.

### Neni 14

#### Administrimi i shoqërisë dhe kompetencat e administratorit

- 1) Administratori i shoqërisë emërohet **Znj.Orkida Bleta**, atësia Krenar, amësia Valentina, shtetase Shqiptare, lindur në Vlorë dhe banuese në Vlorë, me adresë Osman Haxhiu; Vlorë; 0000; Vlorë, lindur më 09/01/1985, gjendja civile “beqare”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035193405 dhe nr. personal I551090740, me afat emërimi 5 vjeçar. Mandati është i rinovueshëm.
- 2) Administratori i shoqërisë mund të zëvendësohet shkarkohet nga pozicioni që ka në Shoqëri në çdo kohë, nga Asambleja e Ortakëve. Në asnjë rast ortakëve nuk i duhet të justifikojnë apo provojnë se cilat janë shkaqet për të cilat ato shkarkojnë administratorin. Në çdo rast janë ortakët ata të cilët vlerësojnë se ka shkaqe të arsyeshme për shkarkimin e administratorit.
- 3) Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë në mënyrë të plotë për administrimin e zakonshëm të saj, si dhe të drejtën për të miratuar të gjitha vendimet që i gjykon të përshtatshme për të arritur dhe përmbushur qëllimin e shoqërisë, me përjashtim të vendimeve që me ligj i takojnë Asamblesë së Ortakëve. Administratori bazuar në një vendim të Asamblesë së Ortakëve, me anë të një prokure të miratuar para noterit mund të autorizojë palë të treta për ta përfaqësuar atë në transaksione të veçanta.
- 4) Administratori ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:
  - a. kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b. të përfaqësojnë shoqërinë tregtare kundrejt palëve të treta dhe shtetit

- c. kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- 5) ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - a. krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- 6) dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - a. raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
  - b. Administratori i shoqërisë nuk mund të blejë dhe/ose shesë pasuri të paluajtshme dhe/ose të luajtshme, pa marrë më parë miratimin paraprak me shkrim të Asmblesë së ortakëve.

#### **Neni 15** **Eksperti kontabël**

- 1) Asambleja e ortakëve mund të emërojë një ose disa Shoqëria ekspert kontabël të cilët kanë detyrën të kryejnë kontrollin kontabël dhe financiar të shoqërisë.
- 2) Eksperti kontabël mban përgjegjësi për mirëmbajtjen e rregullt të gjithë dokumentacionit financiar dhe kontabël të shoqërisë
- 3) Ato përgjigjen për demet që i vijnë shoqërisë nga mbajtja e pa rregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.

#### **KREU IV** **MARDHENIET E PUNES**

#### **Neni 16** **Marrëdhëniet e punës**

- 1) Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratave të punës. Për çeshtjet që kjo kontratë nuk i parashikon zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi. Të punësuarit duhet të përgjigjen për demet që i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet apo mosveprimet e tyre sipas ligjit.

#### **Neni 17** **Sekreti i punës**

- 1) Te gjithë të punësuarit në shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës së shoqërisë. Kjo detyrë vazhdon edhe pas largimit të tyre nga shoqëria.



**KREU V**  
**VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E DIVIDENTIT**

**Neni 18**  
**Viti financiar**

- 1) Vitit financiar i aktivitetit të Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti. Përjashtimisht Viti I pare financiar i Shoqërisë fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne regjistrin tregtar dhe përfundon me datë 31 Dhjetor.

**Neni 19**  
**Raportet vjetore**

- 1) Ne mbylljen e çdo viti financiar administratori dhe eksperti kontabël harton inventarët dhe llogarite vjetore ne përputhje me dispozitat ligjore ne fuqi për kontabilitetin si dhe harton një raport me shkrim për ortakët.
- 2) Raporti pasqyron gjendjen e shoqërisë gjate vitit financiar te kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtaritë e rëndësishme etj.
- 3) Bilancet vjetore, inventari, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabël te autorizuar miratohen nga ortakët sipas Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”.

**Neni 20**  
**Dividenti**

- 1) Pasi të jene përmbushur kërkesat e percaktuara nga Ligji per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, Shoqeria, me shumicë te kualifikuar të votave të Asamblesë te Pergjithshme, mund të vendosë shperndarjen e dividendëve në perputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- 2) Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
  - a. aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
  - b. shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.
- 3) Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 1 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.
- 4) Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

**KREU VI**  
**PRISHJA DHE LIKUJDIMI, LIGJI I ZBATUESHEM, ZGJIDHJA E**  
**MOSMARRVESHJEVE**



**Neni 21**  
**Prishja dhe likuidimi i shoqërisë**

- 1) Në rastin e prishjes dhe likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

**Neni 22**  
**Baza Ligjore**

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.


**Neni 23**  
**Mosmarrëveshjet**

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.


**Neni 24**  
**Dispozita përfundimtare**

- 1) Ky Akt Themelimi dhe Statut u hartua në dy , me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike, në gjuhën shqipe, u miratua nga ortakët e shoqërisë "THE ELIXIR CLINIC" sh.p.k, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emër, mbiemër dhe firmën.

**O R T A K Ë T**  
**E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"THE ELIXIR CLINIC" shpk**



**(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)**



**(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)**